Një vështrim mbi
Kartën Sociale



Karta Sociale Europiane

Një traktat i Këshillit të Europës që mbron të drejtat e njeriut

Karta Sociale Europiane (më poshtë e quajtur "Karta") parashikon të drejta dhe liri si dhe ngre një mekanizëm mbikëqyrës që garanton respektimin e tyre nga Shtetet Palë. Ajo u ndryshua kohëve të fundit dhe Karta Sociale e ndryshuar më 1996, e cila hyri në fuqi më 1999, po zëvendëson gradualisht traktatin fillestar të 1961-it.

Tabela në faqet 8 dhe 9 tregon se cilat vende e kanë nënshkruar dhe ratifikuar aktualisht Kartën.

Të drejtat e garantuara nga Karta

Të drejtat e garantuara nga Karta kanë të bëjnë me të gjithë individët në jetën e tyre të përditshme.

➔ **Strehimi:**
- akses i përgjithshëm ndaj një strehimi të përshtatshëm dhe të përballueshëm;
- ulje e numrit të të pastrehëve; politika të tilla strehimi me synim kategoritë e pafavorizuara;
- proçedura për të limituar nxjerrjen me forcë jashtë banesave;
- akses i barabartë për të huajt në programet sociale të strehimit;
- ndërtimi i shtëpive në përputhje me nevojat e familjarëve.

➔ **Shëndeti:**
- struktura të kujdesit shëndetësor efektive dhe me akses për të gjithë popullsinë;
- politika për të parandaluar sëmundjet sidomos me garanci për mjedis të shëndetshëm;
- mënjanimi i rreziqeve në punë duke siguruar që shëndeti dhe siguria në punë parashikohen me ligj dhe garantohen në praktikë;
- mbrojtje e shtatzanisë.

➔ **Arsimimi:**
- Arsimim fillor dhe i mesëm falas;
- Shërbime udhëzimi profesional falas;
- Akses ndaj trajnimeve fillestare (atyre të përgjithshme dhe të formimit dytësor profesional), arsimim universitar apo i lartë jo-universitar, formim professional duke përfshirë dhe trajnim të vazhdueshëm;
- Masa të veçanta për rezidentë të huaj;
- Integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në shkolla të përshtatshme për ta;
- Akses të personave me aftësi të kufizuar ndaj arsimimit dhe formimit profesional.

➔ **Punësimi:**
- Ndalim i punës së detyruar;
- Ndalim i punësimit të fëmijëve nën moshën 15 vjeç;
- Kushte të veçanta pune për moshat ndërmjet 15 dhe 18 vjeç;
- E drejta e secilit për të siguruar jetesën nëpërmjet një profesioni të zgjedhur lirisht;
- Politika sociale dhe ekonomike të hartuara me qëllim sigurimin e një punësimi të plotë;
- Kushte të drejta pune lidhur me pagesën dhe orarin e punës;
- Mbrojtje ndaj ngacmimeve seksuale apo psikologjike;
- Liri për të formuar sindikata dhe organizata të punëdhënësve me qëllim mbrojtjen e interesave ekonomike dhe sociale; liri individuale për të vendo sur për anëtarësim në to apo jo;
- Nxitje e këshillimeve të përbashkëta, negociatave kolektive, pajtimit dhe arbitrazhit vullnetar;
- Mbrojtje në rast pushimi nga puna;
- E drejta për grevë;
- Akses të personave me aftësi të kufizuar në tregun e punës.

➔ **Mbrojtja Ligjore dhe Sociale:**
- Status ligjor i fëmijës;
- Trajtim i veçantë për ata që thyejnë ligjin;
- Mbrojtje nga keqtrajtimet apo abuzimet;
- Ndalim i rreptë i çdo lloj forme të trafikimit (atij seksual apo lloji tjetër);
- Mbrojtje ligjore e familjes (vendosje barazisë ndërmjet bashkëshortëve dhe të detyrimeve dhe të

drejtave të tyre ndaj fëmijëve, mbrojtje e fëmijëve në rastet e divorceve);
- E drejta për sigurim shoqëror, ndihmë sociale dhe shërbime sociale;
- E drejta për tu mbrojtur nga varfëria dhe përjashtimi social;
- Kujdesi për fëmijët;
- Masa të veçanta kujdesi për moshën e tretë.

➔ **Lëvizja e njerëzve:**
- E drejta për bashkim familjar;
- E drejta e vendasve për tu larguar nga vendi i tyre;
- Procedura mbrojtëse në rast dëbimi nga vendi;
- Thjeshtësim të procedurave të imigrimit.

➔ **Mos-Diskriminim:**
- E drejta e grave për trajtim të barabartë me burrat dhe për mundësi të barabarta punësimi;
- Një garanci për të gjithë vendasit dhe rezidnetët e huaj me leje qëndrimi apo punësimi, se të gjitha të drejtat e parashikuara në Kartë zbatohen pa dallim race, seksi, moshe, ngjyre, gjuhe, feje, opinionesh kombëtare, prejardhjeje sociale, gjendjeje shëndetësore ose shoqërizimi me një minoritet kombëtar;
- Ndalim i diskriminimit mbi baza përgjegjësish familjare;
- E drejta e personave me aftësi të kufizuar për integrim social dhe pjesëmarrje në jetën komunitare.

Shtetet anëtare të Këshillit të Europës dhe të Kartës Sociale Europiane

Situata më 03/03/2010

Shtetet anëtare	Firmosja	Ratifikimi	Pranimi i procedurës së ankesave kolektive
Shqipëria	21/09/98	14 /11/02	
Andora	04/11/00	12 /11/04	
Armenia	18/10/01	21/01/04	
Austria	07/05/99	**29/10/69**	
Azerbaixhani	18/10/01	02/09/04	
Belgjika	03/05/96	02/03/04	23/06/03
Bosnia-Herzegovina	11/05/04	07/10/08	
Bullgaria	21/09/98	07/06/00	07/06/00
Kroacia	06/11/09	**26/02/03**	26/02/03
Qipro	03/05/96	27/09/00	06/08/96
Republika Çeke	04/11/00	**03/11/99**	
Danimarka *	03/05/96	**03/03/65**	
Estonia	04/05/98	11/09/00	
Finlanda	03/05/96	21/06/02	17/07/98 X
Franca	03/05/96	07/05/99	07/05/99
Gjeorgjia	30/06/00	22/08/05	
Gjermania *	29/06/07	**27/01/65**	
Greqia	03/05/96	**06/06/84**	18/06/98
Hungaria	07/10/04	20/04/09	
Islanda	04/11/98	**15/01/76**	
Irlanda	04/11/00	04/11/00	04/11/00
Italia	03/05/96	05/07/99	03/11/97
Letonia	29/05/07	**31/01/02**	

Lihtenshtejni	**09/10/91**		
Lituania	08/09/97	29/06/01	
Luksemburgu *	11/02/98	**10/10/91**	
Malta	27/07/05	27/07/05	
Moldova	03/11/98	08/11/01	
Monako	05/10/04		
Mali i Zi	22/03/05	03/03/10	
Hollanda	23/01/04	03/05/06	03/05/06
Norvegjia	07/05/01	07/05/01	20/03/97
Polonia	25/10/05	**25/06/97**	
Portugalia	03/05/96	30/05/02	20/03/98
Rumania	14/05/97	07/05/99	
Federata Ruse	14/09/00	16/10/09	
San-Marino	18/10/01		
Serbia	22/03/05	14/09/09	
Republika Sllovake	18/11/99	23/04/09	
Sllovenia	11/10/97	07/05/99	07/05/99
Spanja	23/10/00	**06/05/80**	
Suedia	03/05/96	29/05/98	29/05/98
Zvicra	**06/05/76**		
"Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë"	27/05/09	**31/03/05**	
Turqia	06/10/04	27/06/07	
Ukraina	07/05/99	21/12/06	
Mbretëria e Bashkuar *	07/11/97	**11/07/62**	
Numri i Shteteve 47	**2** + 45 = 47	**13** + 30 = 43	14

Datat me shkronja më të nxira i korrespondojnë firmosjes ose ratifikimit të Kartës së 1961-shit ; datat e tjera i korrespondojnë firmosjes ose ratifikimit të Kartës së ndryshuar të 1996-ës.

* Shtete, ratifikimi i të cilave është i nevojshëm që të hyjë në fuqi Protokolli Amendues i 1991-shit. Në praktikë, me vendim të Komitetit të Ministrave, ky Protokoll është tashmë në zbatim.
X Shtete që kanë njohur të drejtën e OJQ-vë kombëtare për të paraqitur ankesa kolektive kundër vetë shtetit.

Komiteti europian për të drejtat sociale

Komiteti Europian i të Drejtave Sociale (më poshtë i quajtur "komiteti") verifikon nëse vendet kanë përmbushur angazhimet e parashikuara nga Karta. Pesëmbëdhjetë anëtarët e tij të pavarur e të paanshëm zgjidhen nga **Komiteti i Ministrave** i Këshillit të Europës për një periudhë prej gjashtë vjetësh, që rinovohet vetëm një herë. Komiteti vendos nëse legjislacioni dhe praktika kombëtare në Shtetet Palë janë ose jo në përputhje me Kartën (Neni 24 i Kartës, sic është ndryshuar nga **Protokolli i Torinos** i 1991-it).

➔ Një procedurë monitorimi e bazuar në raportet kombëtare

Çdo vit Shtetet Palë paraqesin një **raport** ku tregojnë se si e zbatojnë Kartën në Legjislacion dhe Praktike. Çdo raport ka të bëjë me disa nga **dispozitat e pranuara** të Kartës.

Komiteti shqyrton raportet dhe vendos nëse situatat në vendet në fjalë janë në përputhje me Kartën ose jo. Vendimet e tij, të njohura si **"konkluzione", botohen cdo vit**.

Nëse një shtet nuk vepron në vijim të një vendimi të Komiteti në kuptimin që ai nuk vepron në përputhje me Kartën, Komiteti i Ministrave i drejton atij shteti një rekomandim, duke i kërkuar të ndryshojë situatën në legjislacion a praktikë. Puna e Komitetit të Minisrave përgatitet nga një Komitet Qeveritar që përbëhet nga përfaqësues të qeverive të Shteteve Palë në Kartë, të ndihmuar nga vëzhgues që përfaqësojnë organizatat e punëdhënësve dhe sindikatat europiane.

➔ Një proçedurë ankese kolektive

Sipas një **protokolli** të hapur për firmosje më 1995, i cili hyri në fuqi më 1998, ankesa për shkelje të Kartës mund të regjistrohen në Komitetin Europian të të Drejtave Sociale.

Organizata që kanë të drejtë të rregjistrojnë ankesa në Komitet

– *Në rastin e të gjitha shteteve që kanë pranuar procedurën:*

1. ETUC, BUSINESSEUROPE dhe IOE [1] ;
2. Organizatat joqeveritare (OJF) me status konsultativ me Këshillin e Europës të cilat janë në një listë të hartuar për këtë qëllim nga Komiteti Qeveritar;
3. Organizatat e Punëdhënësve dhe Sindikatat në vendin në fjalë;

– *Në rastin e shteteve që e kanë pranuar këtë:*

4. OJF-të kombëtare

Ankesa e rregjistruar duhet të përmbajë informacionin e mëposhtëm:

a. emrin dhe hollësitë e kontaktimit të organizatës që paraqet ankesën;
b. provë se personi që paraqet dhe nënshkruan ankesën ka të drejtë të përfaqësojë organizatën që rregjistron ankesën;
c. shtetin kundër të cilit drejtohet ankesa;
d. një tregues për ato dizpozita të kartës që pretendohen të jenë shkelur;
e. temën e ankesës, d.m.th. pikën (pikat) lidhur me të cilat shteti në fjalë pretendohet se nuk ka vepruar në përputhje me Kartën, së bashku me argumentet përkatëse, me dokumentet mbështetëse.

Ankesa mund të paraqitet lirisht e mbështetur në sa më lart ose duke përdorur një formular. Ajo duhet të hartohet në anglisht ose frëngjisht në rastin e organizatave të kategorisë 1 dhe 2 më lart. Në rastet e tjera (kategoritë 3 dhe 4), ajo mund të hartohet në gjuhën zyrtare, ose në një nga gjuhët zyrtare të shtetit në fjalë.

Komiteti shqyrton ankesën dhe nëse janë përmbushur kërkesat formale, e deklaron atë të pranueshme. Sapo ankesa të deklarohet e pranueshme, vihet në lëvizje një procedurë me shkrim, me shkëmbim letrash nëpërmjet palëve. Komiteti mund të vendosë të mbajë një seancë dëgjimore me dyer të hapura.

1. ETUC : Konfederata e Sindikatave Europiane ; BUSINESSEUROPE : ish UNICE ; IOE : Organizata Ndërkombëtare e Punëdhënësve.

Më pas Komiteti merr një vendim mbi themelin e ankesës, të cilën ai ja dërgon palëve në fjalë dhe Komitetit të Ministrave në një **raport**, i cili bëhet publik brenda katër muajve pasi është dërguar.

Në fund Komiteti i Ministrave miraton një **rezolutë**. Nëse është me vend ai mund të **rekomandojë** që shteti në fjalë të marrë masa specifike për ta sjellë situatën në vijë me Kartën.

Efektet e zbatimit të Kartës në shtete të ndryshme

Si rezultat i sistemit të monitorimit, shtetet bëjnë mjaft ndryshime në legjislacionin ose praktikën e tyre për të sjellë situatën në vijë me Kartën. Hollësi të këtyre rezultateve (dhe të zhvillimeve aktuale) përshkruhen në "Survey", që botohet cdo vit nga Sekretariati i Kartës (shihni më poshtë).

➔ Ku të mësojmë më shumë për Kartën

- website i Kartës **www.coe.int/socialcharter** përmban në vecanti të gjitha raportet kombëtare konkluzionet dhe fletë-faktesh për cdo vend;
- baza e të dhënave e Kartës që mund të vizitohet online ose me CD Rom e bën të lehtë të merret informacion për praktikën gjyqësore të Komitetit Europian të të Drejtave Sociale;
- "Collected texts" (Tekste të përmbledhura) përmbajnë të gjitha tekstet bazë;
- bibliografia përmbledhëse përditësohet rregullisht.



Karta Sociale Europiane

Albanian version

Department of the European Social Charter
Directorate General of Human Rights and Legal Affairs
Council of Europe
F – 67075 Strasbourg Cedex
social.charter@coe.int

Cover: Christophe Nutoni - www.creative-instinct.com
Coordination: Directorate of Communication and Research
Printed in the Council of Europe workshops
2010